



LICENCË PËR FURNIZIM PUBLIK ME NGROHJE¹

DHËNË :

“NGROHTORES SË QYTETIT GJAKOVA” SH.A

Numri i Regjistrimit: ZRRE/Li_04/12

¹ Tani e tutje në këtë Licencë në vend të shprehjes “ngrohje” përdoret shprehja teknikisht më e përshtatshme “energji termike për ngrohje qendrore”.



PËRMBAJTJA:

KREU I: TERMAT E LICENCËS.....	3
KREU II: KUSHTET E LICENCËS	4
Neni 1: Përkufizimet.....	4
Neni 2: Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit.....	5
Neni 3: Ndalimi i Ndër-subvencioneve	6
Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit	6
Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.....	7
Neni 6: Mbrojtja e Konsumatorëve.....	7
Neni 7: Detyrimet e të Licencuarit	7
Neni 8: Identifikimi dhe Parandalimi i Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Termike ...	8
Neni 9: Informimi i Konsumatorëve	9
Neni 10: Shëndeti dhe Siguria	9
Neni 11: Puna	9
Neni 12: Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante të të Licencuarit	9
Neni 13: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit	10
Neni 14: Obligimet e Shërbimit Publik	10
Neni 15: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së	10
Neni 16: Vazhdimi, Modifikimi Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës.....	11
Neni 17: Taksat.....	11
Neni 18: Masat Administrative dhe Gjobat	11
Neni 19: Zgjidhja e Kontesteve.....	12



KREU I: TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji (tani e tutje "ZRRE")**, në pajtim me autoritetin e dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185), Nenin 15 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 03/L-184), Nenin 5 të Ligjit për Ngrohje Qendrore (Ligji Nr. 03/L-116) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, **i modifikon Ngrohtores së Qytetit "GJAKOVA" SH.A.** (tani e tutje "i Licencuari") **Licencën për Furnizim Publik me ngrohje.**
2. Territori që mbulohet nga kjo licencë është territori i Komunës së Gjakovës.
3. I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me Nenet dhe kushtet e përcaktuara në këtë licencë, Ligjin për Ngrohjen Qendrore dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
4. I Licencuari do të veprojë si vijon:
 - 4.1 shesë energji termike për ngrohje konsumatorëve të rregulluar me çmime të rregulluara;
 - 4.2 shesë energji termike për ngrohje konsumatorëve të privilegjuar në përputhje me procedurat e nxjerra nga ZRRE-ja;
 - 4.3 blejë energji termike për ngrohje me çmime të rregulluara nga prodhuesit me kapacitet mbi 1 MW në përputhje me nenin 7 të Ligjit për ngrohje qendrore dhe nenin 41 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 4.4 blejë energji termike për ngrohje me çmime të parregulluara nga prodhuesit tjerë;
 - 4.5 faturojë dhe mbledhë pagesat nga konsumatorët e vet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Ngrohjen Qendrore dhe Rregullat tjera në fuqi;
 - 4.6 merret me ankesat e konsumatorëve të vet.
5. Licenca vlen nga data **04 Tetor 2006** dhe do të vazhdojë të jetë e vlefshme për një periudhë tridhjetë (30) vjeçare, deri **04 Tetor 2036** me mundësi vazhdimi në pajtim me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
6. Në pajtim me Nenin 34 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë modifikon licencën për Furnizim Publik me Ngrohje Qendrore me numër Licence ZRRE/ Li_12/06 e lëshuar me datë 04 tetor 2006 nga Zyra e Rregullatorit për Energji, dhe hynë në fuqi me datë **12.10.2012**.

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë: _____.

Nënshkruar nga Enver Halimi (në emër të Bordit të ZRRE-së): _____.



KREU II: KUSHTET E LICENCËS

Neni 1: Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptimin si në vijim:

"Anëtar" - marrëdhënia e drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo ndërmarrje Aksionare apo Vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës të një ndërmarrje Aksionare të të Licencuarit, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi.

"Pika furnizuese" - nënstacioni termik prej të cilit fluidi-bartës i energjisë termike, eventualisht edhe uji i ngrohtë sanitarë, i dërgohen konsumatorit të fundit dhe në të cilën bëhet matja e furnizimit me pajisje matëse përkatëse.

"Konsumator i fundit" - konsumatori i cili blen energji termike për ngrohje për përdorim vetanak.

"Vit Raportues" - periudha prej 15 Tetor të vitit aktual deri me 14 Tetor të vitit të ardhshëm.

"Rrjeti i Shpërndarjes së ngrohjes" – sistemi i gypave që bartin energjinë termike për ngrohje nga prodhuesi tek konsumatorit.

"Ndërmarrje e Ngrohjes qendrore" – subjekti i licencuar që përmbush aktivitetet e licencuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

"Sistemi i Ngrohjes qendrore" - sistemi i integruar dhe i kyçur i gjenerimit, shpërndarjes dhe furnizimit.

"Legjislacion" - Ligji për Energjinë (Ligji Nr. 03/L - 184), Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L - 185), Ligji për Ngrohje Qendrore (Ligji Nr. 03/L-116) si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.

"Kod i Matjes" – përmbledhje e rregullave dhe procedurave që përcaktojnë mënyrën e leximit të njësorëve (matësve), llogaritjes së energjisë së harxhuar, faturimit dhe arkëtimit në sektorin e ngrohjes.

"Pajisjet matëse" – instrumenti i regjistruar në regjistrin për certifikimin e pajisjeve matëse, të cilat përdoren në procesin e prodhimit dhe të furnizimit me energji termike për ngrohje.

"Furnizues" - personi juridik apo fizik i pajisur me leje të rregullt për të kontraktuar me konsumatorin lidhur me shitjen ose rishitjen e energjisë termike për ngrohje.

"Furnizim" – dërgimi, shtija dhe rishitja e energjisë termike për ngrohje te konsumatorët.



“**Vartës**” -çdo ndërmarrje në pronësi apo e kontrolluar nga një ndërmarrje tjetër, e që definohet sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

2. Termet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptim si termet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.

Neni 2: Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit

1. I Licencuari do të përgatisë dhe dorëzojë në ZRRE Pasqyrat Financiare vjetore të audituara nga auditori i pavarur në përputhje me Ligjet vendore në fuqi dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar.
2. I Licencuari do të përgatisë Pasqyrat Rregullative vjetore në përputhje me Udhëzimin për Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore, nxjerrë nga ZRRE-ja, dhe do t'i dorëzoj ZRRE-së një kopje të këtyre Pasqyrave brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit raportues.
3. I Licencuari në kontabilitetin e vet të brendshëm do të mbajë llogari të ndara për aktivitetin e Furnizimit publik si tërësi, që po ashtu duhet të jenë të ndara për:
 - 3.1 furnizim të konsumatorëve të kualifikuar me tarifa të rregulluara
 - 3.2 furnizim të konsumatorëve të kualifikuar me tarifa të parregulluara;
 - 3.3 furnizim të konsumatorëve të pakualifikuar; dhe
 - 3.4 aktivitetet e tjera që nuk kanë të bëjnë me ngrohjen.
4. I Licencuari gjithashtu në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin (llogari) të ndara për kontratat me konsumatorët e tij për instalimin, servisimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit sekondar nga pika e shpërndarjes, në përputhje me Nenin 22 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore. Nëse kërkohet nga ZRRE-ja kohë pas kohe, i Licencuari duhet të dërgoi të gjitha llogaritë në formë dhe datën e specifikuar nga ZRRE. Kontabiliteti rregullativ do të mbahet në përputhje me Udhëzimet e për Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore, që ndër të tjerash mund të specifikojnë:
 - 4.1. formën e Pasqyrave / deklaratave rregullative të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në Pasqyrën e të Ardhurave (fitimit/ humbjes, bilancin e gjendjes, Pasqyrat e pranuar të fitimevedhe humbjeve, Pasqyrën e rrjedhjes së parave të gatshme bilancin e energjisë termike (ngrohjes), si dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostot, asetet, borxhet, rezervat ose furnizimet të cilat janë faturuar nga ndonjë aktivitet tjetër, ose i janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktiviteteve të konsoliduara të Furnizimit Publik dhe aktivitetit tjetër;



- 4.2. natyrën dhe përmbajtjen e Pasqyrave/deklaratave rregullative të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose borxheve dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, shpenzimet, asetet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara;
 - 4.3. parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazën për alokimin e shpenzimeve).
5. Në lidhje me pasqyrat/deklaratat e kontabilitetit rregullativ për vitin financiar (raportues), i Licencuari nuk duhet, sa i përket gjendjeve llogaritare në lidhje me vitet financiare, të ndryshoj bazat e tarifave, shpërndarjen ose alokimin që janë përdorur në vitin financiar paraprak, përveç nëse ZRRE-ja ka lëshuar më parë udhëzimin relevant apo jep aprovimin me shkrim për ndryshimin në ato baza.
 6. I Licencuari do të veproj në pajtim me çdo udhëzim të nxjerr nga ZRRE-ja dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 3: Ndalimi i Ndër-subvencioneve

1. I Licencuari do të parandalojë apo evitojë që aktiviteti i furnizuesit publik të japë apo të marrë ndonjë subvencion ose ndër-subvencion (direkt apo të tërthortë) prej ndonjë aktiviteti tjetër të Licencuarit ose ndonjë Vartësi (ortaku) apo anëtarit ose nga ndonjë person tjetër.
2. I Licencuari do të sigurojë se nuk do të lejoj ndonjë ndër-subvencion (drejtpërdrejt ose tërthortë) në mes të konsumatorëve të kualifikuar me tarifa të rregulluara dhe të parregulluara, dhe as në mes të konsumatorëve të kualifikuar dhe jo-kualifikuar të tij, dhe as në mes të ndonjë konsumatori tjetër të tij individual apo kategori konsumatorësh, përveç në nivelin e aprovuar nga ZRRE.

Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit

1. I Licencuari nuk do të furnizojë ose nuk do të ofrojë të furnizojë me energji termike për ngrohje ndonjë blerës ose person, me çmimin që është materialisht më shumë ose më pak i favorshëm se çmimi me të cilin furnizuesi furnizon ose ofron të furnizojë me energji termike për ngrohje blerësit e krahasueshëm.
2. I Licencuari në ç'do kohë do t'i raportoj ZRRE-së lidhur me rrethanat e shitjes/blerjes së energjisë termike për ngrohje ndaj blerësve/shitësve, duke përfshirë (pa kufizim) vëllimin, faktorët e ngarkesës (kapacitetit), kushtet e ndërprerjes, afatet dhe kohëzgjatjen e marrëveshjeve përkatëse.



Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji

1. I Licencuari do të veproj në përputhje me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, Kodet e Matjes dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
2. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e atyre dispozitave që nuk është e mundur të zbatohen sipas paragrafit 1 të këtij Neni. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i Licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 6: Mbrojtja e Konsumatorëve

1. I Licencuari do të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues ndaj të gjithë konsumatorëve, sa i përket të drejtave dhe detyrimeve të tyre në lidhje me shërbimet e ngrohjes qendrore .
2. I Licencuari është përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorëve të vet, duke bërë adresimin e ankesave në lidhje me çdo veprim, mospërfillje ose shkelje të bëra nga vet furnizuesi apo operatori i sistemit, si dhe duke bërë përpjekje të arsyeshme për të zgjidhur këto ankesa.
3. I Licencuari duhet të sigurojë të paktën një zyrtar gjatë orëve të punës, që t'iu përgjigjet pyetjeve dhe kërkesave të konsumatorëve.
4. Zyrtarët e të Licencuarit që janë përgjegjës për marrjen e telefonatave dhe pranimin e konsumatorëve në zyrë, duhet të jenë të kualifikuar dhe të udhëzuar siç duhet, për mënyrën se si të trajtojnë me shpejtësi çështjet e ankesave/kontesteve dhe kërkesave për shërbim apo t'i udhëzojë në departamentin përkatës.
5. I licencuari do të sigurojë një shërbim 24-orësh për t'iu përgjigjur telefonatave të konsumatorëve lidhur me ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve.
6. I Licencuari duhet që kërkesave të parashtruara nga konsumatorët përmes telefonit, apo me shkrim t'iu përgjigjet me shkrim.
7. I Licencuari do të informoj konsumatorët e tij për adresën postare, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresës elektronike të shërbimit të informatave, që themelohet dhe vepron për qëllime të pranimit të raporteve nga çdo person lidhur me ndonjë çështje apo incident.

Neni 7: Detyrimet e të Licencuarit

1. I Licencuari do të kryej aktivitetin e licencuar në Kosovë në mënyrë efektive, ekonomike dhe në mënyrë të koordinuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



2. I Licencuari do të ndërmerr të gjithë masat e nevojshme që të zbatojë obligimet sipas legjislacionit në fuqi, dispozitat e kësaj licence dhe me marrëveshjet e lidhura me palë.
3. I Licencuari do të përgatisë një kontratë komerciale dhe do t'ia propozojë këtë konsumatorëve të kualifikuar që kanë zgjedhur të furnizohen nga Furnizuesi Publik, në përputhje me Rregullin për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Ligjit për Ngrohjen Qendrore.
4. I Licencuari brenda afatit të paraparë me Ligjin për Ngrohjen Qendrore, do të përgatisë Kodin për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe do ta dorëzojë për aprovim në ZRRE.
5. I Licencuari do të lidhë kontrata afatgjate të blerjes me prodhuesit, në atë masë që nevojitet për të garantuar furnizim të mjaftueshëm, në përputhje me Nenin 19 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore. Këto kontrata i nënshtrohen aprovimit të ZRRE-së.
6. I Licencuari do t'i japë prioritet blerjes së energjisë termike për ngrohje për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës, në përputhje me Nenin 12 të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

Neni 8: Identifikimi dhe Parandalimi i Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Termike

1. I Licencuari do të ndërmarrë të gjithë masat e arsyeshme me qëllim të identifikimit dhe parandalimit të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike për ngrohje, dhe shkeljeve tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari do të zbatojë Procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë termike për ngrohje, të aprovuar nga ZRRE.
3. I licencuari duhet ti ndërmarr masat për të parandaluar:
 - 3.1. vjedhjen e energjisë termike për ngrohje në ndërtesat të cilat furnizohen nga i Licencuari;
 - 3.2. dëmtimin ose defektin e ndonjë njehsori (matësi) të energjisë termike përmes të cilit njehsohet (matet) furnizimi në ndërtesa;
 - 3.3. ndërhyrjen në ndonjë njehsor (matës) të energjisë termike përmes të cilit njehsohet (matet) furnizimi në ndërtesa; dhe
 - 3.4. ndonjë konsum të paregjistruar të energjisë termike në ndërtesat që furnizohen nga i Licencuari.
4. I Licencuari, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, do të informojë menjëherë pronarin/operatorin përkatës të rrjetit sekondar ose njehsorit për çdo incident që ka të bëjë:
 - 4.1. me dëme apo defekte në ndonjë tubacion të rrjetit sekondarë ose njehsor (matës);
 - 4.2. me ndërhyrje në njehsor (matës); dhe



4.3. me konsumin e energjisë termike në objektet/ndërtesat që furnizohen nga i Licencuari pa qenë të regjistruar.

Neni 9: Informimi i Konsumatorëve

1. I Licencuari do t'i mbajë të informuar konsumatorët e vet (përveç nëse konsumatori furnizohet me energji termike për ngrohje që nuk kalon nëpërmes njehsorit) për sasinë e energjisë termike, që është regjistruar si e harxhuar nga ai konsumator, sipas njehsorit (matësit) përmes të cilit konsumatori është furnizuar.
2. I Licencuari do t'i mbajë të informuar konsumatorët e vet mbi Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, si dhe rolin e ZRRE-së në zgjidhjen e kontesteve të tilla.
3. I Licencuari do t'i kryejë detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij Neni duke siguruar informatën relevante për secilën faturë apo deklaratë që i është dhënë konsumatorit, në lidhje me detyrimet për furnizimin me energji termike për ngrohje.

Neni 10: Shëndeti dhe Siguria

I Licencuari do të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për t'i mbrojtur personat nga lëndimet dhe dëmtimet që mund t'u shkaktohen atyre nga ana e të Licencuarit gjatë kryerjes së aktivitetit të Furnizimit Publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11: Puna

I Licencuari lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë do të veproj në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 12: Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante të të Licencuarit

1. I Licencuari do të përgatisë dhe do të mirëmbajë një regjistër për të gjitha asetet relevante dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së këtë regjistër, jo më vonë se 31 Janar të çdo viti.
2. I Licencuari nuk do ta shes apo heq dorë nga kontrolli funksional mbi ndonjë aset relevant, nëse kjo do të ndikonte në aftësinë për ti kryer obligimet e tija apo nëse aset i ka vlerën e zëvendësimit mbi njëqind mijë euro (100,000.00 €).
3. Në rast kur i Licencuari dëshiron të shesë (tjetërsojë) asete apo pasuri tjera që përdoren në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, ku vlera e tyre e tejkalon shumë njëqind mijë euro (100,000.00 €), i Licencuari është i obliguar që ta njoftojë ZRRE-në me shkrim dhe kërkon miratimin e ZRRE-së. I Licencuari mund ta bëjë tjetërsimin e ndonjë asemi të tillë vetëm pas miratimit me shkrim nga ZRRE-ja.



4. E njëjta si më paragrafin 2 të këtij Neni aplikohet edhe për dhënien në shfrytëzim të aseteve ose burimeve (resurseve) të tjera që përdoren për të kryer aktivitetin e licencuar.

5. Në këtë Nen:

"Tjetërsimi"-çdo shitje, transferim, dhurim, dhënien me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizimin mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor) ose ndonjë pagesë tjetër, si dhe lejim i ndonjë pagese ndaj një aktiviteti tjetër të të Licencuarit dhe/ose pale të tretë.

"Aset relevant" - çdo pajisje dhe çdo pasuri e luajtshme ose e paluajtshme e përdorur nga i Licencuari për ushtrimin e aktivitetit të furnizimit publik me energji termike për ngrohje, përfshirë, çdo interes ligjor apo të dobishëm për ndonjë tokë apo objekt dhe çdo pronësi intelektuale.

Neni 13: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit

1. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll të të Licencuarit së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon.
2. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim të Strukturës Organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet ZRRE-së jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

Neni 14: Obligimet e Shërbimit Publik

I Licencuari do të kryejë çdo obligim të shërbimeve publike që mund t'i vendoset nga ZRRE-ja sipas Nenit 47 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe dispozitave të Ligjit për Ngrohjen Qendrore.

Neni 15: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së

1. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që ZRRE-ja mund ti konsiderojë të nevojshme.
2. I Licencuari do t'i dërgojë ZRRE-së raporte tremujore dhe vjetore mbi veprimtarinë e Furnizuesit Publik si dhe pajtueshmërinë me Nenet dhe kushtet e Licencës sipas Doracakut të Raportimit për Sektorin e Energjisë, të miratuar nga ZRRE-ja.
3. Nëse i Licencuari në përputhje me Rregullin për Informatat Konfidenciale, kërkon që një informacion i caktuar të konsiderohet si konfidencial atëherë është obligim i tij që të shënjoj atë informacion si konfidencial dhe të arsyetoj kërkesën e tij tek ZRRE-ja. ZRRE do të shqyrtojë kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
4. ZRRE-ja ka të drejtë të kërkojë nga i licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme



për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

5. I Licencuari duhet t'i dërgojë ZRRE-së detajet për çdo ndryshim në informata që janë dërguar gjatë aplikimit për këtë licencë.
6. Në këtë Nen:

"Informacioni" - materiali që në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, llogari kontabël (statutore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

Neni 16: Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës

1. ZRRE-ja mund të vazhdojë, modifikojë, pezullojë, dhe ndërpresë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Ngrohjen Qendrore dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. ZRRE-ja mund të transferojë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionin tjetër në fuqi, por duke siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen (vijne në pozitë të vështirë) për shkak të një transferimi të tillë.

Neni 17: Taksat

I Licencuari do t'i paguajë ZRRE-së çdo taksë të fillestare dhe vjetore të përcaktuar sipas Rregullës për Taksat, të nxjerrë nga ZRRE-ja.

Neni 18: Masat Administrative dhe Gjobat

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi përfshirë Rregullat e nxjerra nga ZRRE apo Nenet dhe kushtet e kësaj Licence apo instruksionet e dhëna të Licencuarit nga ana e ZRRE-së, ZRRE-ja ka kompetenca t'i vendos të licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 52 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.



Neni 19: Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të kontestohen nga i Licencuari në gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.